

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr.9743, datë 28.5.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 "PËR URBANISTIKËN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 9 paragrafi i parafundit ndryshohet si më poshtë:

"- Lejet e ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore kombëtare."

Neni 2

Neni 10 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19

KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës përbëhet nga 9 anëtarë. Anëtarët e KRRT-së së Bashkisë së Tiranës janë:

- Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Kryetar i KRRT-së;
- 3 anëtarë, me propozimin e shumicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- 3 anëtarë, me propozimin e pakicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- 1 anëtar, përfaqësues i ministrit përgjegjës për planifikimin urban;
- 1 anëtar, që zgjidhet me 3/5 e votave të të gjithë Këshillit Bashkiak të Tiranës."

Neni 4

Në nenin 21, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Vendimet e KRRT-së Tiranë merren me jo më pak se pesë vota pro, përveç rasteve të parashikuara në nenin 20 pika 2 shkronjat "c" dhe "dh", për të cilat vendimet merren me jo më pak se 6 vota pro."

Neni 5

Në fund të nenit 38 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Kërkesat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen në rastin e ndërtimeve të infrastrukturës rrugore publike."

Neni 6

Në nenin 45 fjalia e parafundit ndryshohet si më poshtë:

"Kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularëve 3 dhe 3/1, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i kërkesës për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës."

Neni 7

Në nenin 53 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Leja e ndërtimit i jepet kërkuarit të saj sipas formularit nr.4, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i lejes së ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës."

2. Fjalia e tretë shfuqizohet.

3. Fjalia e parafundit ndryshohet si më poshtë:

"Formulari i lejes plotësohet nga sekretari i KRRT-së/KRRTRSH-së."

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)